



Nr. 05/2024
Data: 12.09.2024

THIRRJE PUBLIKE

PËR MBËSHTETJEN E KONSUMATORËVE FAMILJARË NË INVESTIMIN NË PAJISJE EFIÇIENTE PËR NGROHJE

Që nga viti 2021, kriza energjetike nëpër të cilën po kalon Evropa ka përkeqësuar situatën me furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës. Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të prodhimit vendor të energjisë, varësia nga importi dhe çmimet jostabile të energjisë elektrike në tregun ndërkombëtar kanë krijuar pasiguri në furnizimin me energji elektrike. Një situatë e tillë vlerësohet që pengon edhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës, duke shkaktuar rrjedhimisht kosto të larta për ekonomitë familjare si dhe për bizneset.

Sipas statistikave, konsumatori më i madh i energjisë në Republikën e Kosovës është sektori rezidencial, i cili kontribuon me rreth dyzet për qind (40%) në konsumin final të saj. Ulja e konsumit përmes rritjes së Efiçiençës së Energjisë (EE) ndikon në reduktimin e kërkesës për energji, e cila vazhdon të rritet dukshëm në Republikën e Kosovës gjatë sezonit të dimrit dhe ngrohjes, duke qenë se një numër i konsiderueshëm i amvisërive përdorin energjinë elektrike për ngrohje.

Qeveria e Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh këtë situatë të paqëndrueshme të furnizimit me energji elektrike, ka ndërmarr masa konkrete në adresimin e saj. Në linjë sipas Vendimit¹ Nr. 29/112, më datë 13.12.2022, i plotësuar me Vendimin² Nr.03/128, më datë 16.02.2023, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar Planin e Veprimit për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike në shumë prej shtatëdhjetë e pesë (75) milionë euro, si parakusht për përfitim të mjeteve financiare nga Bashkimi Evropian (BE) për Programin Vjetor IPA 2023. Ky Plan parasheh zbatimin e masave me efekte të menjëhershme dhe afatshkurtra për periudhën e dimrit, përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë financiare për familjet në nevojë dhe në disavantazh social, nxitjen e kursimit të energjisë elektrike nga konsumatorët familjarë, mbështetjen e familjeve përmes rritjes së Efiçiençës së Energjisë (EE) në njësitë e banimit dhe të ndërtesave si dhe investimeve në pajisje efiçiente për ngrohje dhe elektro-shtëpiake dhe sisteme të energjisë së ripërtëritshme për familjet. Bazuar në Masën katër (4) të Planit të Veprimit për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30>

² <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30>



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



**Funded by
the European Union**

Ekonomik të Krizës Energjetike, Ministria e Ekonomisë (ME), shpall Thirrje Publike për mbështetjen e konsumatorëve familjarë, në veçanti konsumatorët në nevojë, investim në instalimin e pajisjeve efikënte për ngrohje, duke përfshirë:

- ✓ *Pompë termike;*
- ✓ *Kondicioner/ klimë efikënte (pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efikëncë të lartë);*
- ✓ *Kaldaja me biomasë (dru, pelet, briket);*
- ✓ *Stufa individuale me biomasë.*



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



**Funded by
the European Union**

1 PAJISJET TË CILAT DO TË SUBVENCIONOHEN PËR KONSUMATORË FAMILJARË

Secili aplikues gëzon të drejtën e përfitimit të subvencionit për vetëm një (1) nga pajisjet e cekura më poshtë:

- ✓ Pompë termike;
- ✓ Kondicioner/ klimë (pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efikasitet të lartë);
- ✓ Kaldaja me biomasë (dru, pelet, briket);
- ✓ Stufa individuale me biomasë.

*Subvencionohen vetëm pajisjet e reja.

Vërejtje: Nëse keni qenë përfitues të subvencionit për blerjen e pajisjeve ngrohëse efikente, të njërës nga thirrjet publike: (i) thirrjes publike Nr.02/2022, më datë 06.10.2022; (ii) thirrjes publike Nr.03/2022, më datë 18.11.2022, ose; (iii) thirrjes publike Nr.03/2023, më datë 22.09.2023, ju nuk keni të drejtë të aplikoni për subvencionim për pajisjet ngrohëse efikente në kuadër të thirrjes publike Nr. 05/2024.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



Funded by
the European Union

2 KRITERET TEKNIKE DHE TË PËRGJITHSHME

Në tabelën më poshtë gjeni kriteret për aplikim, kriteret teknike, vlerën e subvencionit dhe sqarimet shpesh për secilën prej pajisjeve që do të subvencionohen.

Tabela 1.0

PAJISJA	KRITERET PËR APLIKIM	KRITERET TEKNIKE TË PAJISJES	VLERA E SUBVENCIONIMIT	SQARIME SHITESË
Pompë termike	<p>a. Shtëpia ose banesa juaj ngrohet me energji elektrike (<i>Konsumi mujor i energjisë elektrike ka qenë mbi 800 kWh për së paku njërin nga muajt nëntor 2023 - mars 2024</i>)³.</p> <p>b. Kriteri sipas pikës a. nuk vlen për konsumatorët e rinj, të regjistruar⁴ nga data 1 shkurt 2024. Për konsumatorët e rinj kërkohet që të kenë një faturë të paguar të energjisë elektrike</p>	<p>a. Shkalla e performancës/eficiencës të energjisë të jetë minimum A++.</p> <p>b. Të plotësojë një nga kriteret e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Koeficienti i performancës së pompës termike (COP) të jetë 4.2 ose më i lartë, ose;▪ Koeficienti i performancës sezonale	Vlera e subvencionimit për një (1) pajisje është tridhjetë përqind (30%) e vlerës investive dhe deri në 2000.00 €	<p>Subvencionimi përfshin edhe koston e pajisjeve përcjellëse deri në kyçje në rrjet (por jo kosto e montimit).</p> <p>Kjo pajisje është e aplikueshme për shtëpi dhe banesa (vetëm një pajisje).</p>

³ Në formularin për aplikim online e-Kosova, aplikuesit do t'i kërkohet të shënojnë shifrën e konsumatorit të faturës së energjisë elektrike, dhe përmes shifrës së konsumatorit do të merren informatat mbi shpenzimet e konsumit të energjisë elektrike.

⁴ Me të regjistruar konsiderohen konsumatorët që figurojnë në bazën e të dhënave të furnizuesit të energjisë elektrike.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



**Funded by
the European Union**

	<p>për së paku një muaj nga shkurti 2024 deri në momentin e aplikimit. Verifikimi për pagesën e faturës së energjisë elektrike bëhet automatikisht nga e-Kosova⁵.</p> <p>c. Shtëpia ose banesa juaj nuk ka qasje në ngrohje të qytetit ose në ngrohje kolektive.</p> <p>d. Shtëpia ose banesa juaj është e termoizoluar ⁶.</p> <p>e. Shtëpia ose banesa juaj ka të instaluar sistemin qendror të ngrohjes. (<i>Rrjetin e brendshëm të ngrohjes</i>).</p>	<p>(SCOP) të jetë 3.2 ose më i lartë.</p> <p>c. E pajisur me etiketën e konformitetit CE.</p>		
Kondicioner/ klimë eficiente (pompë termike ajër-ajër të tipit	<p>a. Shtëpia ose banesa juaj ngrohet me energji elektrike (<i>Konsumi mujor i energjisë elektrike ka qenë mbi 800 kWh</i></p>	<p>a. Shkalla e performancës/eficiencës të energjisë të jetë minimum A+ për ngrohje.</p>	<p>Vlera e subvencionimit për një (1) pajisje është dyzet përqind (40%) e vlerës investive, dhe deri në 400.00 €</p>	<p>Subvencionimi përfshin vlerën investive për blerjen e pajisjes (me një njësi të jashtme dhe</p>

⁵ Në rast të pamundësisë teknike të verifikimit automatik në e-Kosova kërkohet të bashkëngjitet fatura e energjisë elektrike së bashku me dëshmi të pagesës për së paku një muaj nga shkurti 2024 deri në momentin e aplikimit.

⁶ Mbështjellësi i jashtëm i ndërtesës (shtëpisë/banesës): Muret e jashtme të ndërtesës duhet të jenë të izoluar termikisht (p.sh stitopor, lesh guri) dhe dritaret/dyert e jashtme të jenë në gjendje të mirë teknike dhe fizike dhe së paku të jenë me dy shtresa xhami.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



Funded by
the European Union

<p>inverter me eficiencë të lartë).</p>	<p><i>për së paku njërin nga muajt nëntor 2023 - mars 2024</i>⁷.</p> <p>b. Kriteri sipas pikës a. nuk vlen për konsumatorët e rinj, të regjistruar⁸ nga data 1 shkurt 2024. Për konsumatorët e rinj kërkohet që të kenë një faturë të paguar të energjisë elektrike për së paku një muaj nga shkurti 2024 deri në momentin e aplikimit. Verifikimi për pagesën e faturës së energjisë elektrike bëhet automatikisht nga e-Kosova⁹.</p> <p>c. Shtëpia ose banesa juaj nuk ka qasje në ngrohje të qytetit ose në ngrohje kolektive.</p> <p>d. Banesa juaj ka njërin nga masat e eficiencës së energjisë</p>	<p>b. Koeficienti sezonal i performancës së kondicionerit/klimës (SCOP) të jetë 4.0 ose më i lartë.</p> <p>c. E pajisur me etiketën e konformitetit CE.</p>	<p>Për prindërit vetushqyes¹¹: gjashtëdhjetë përqind (60%) e vlerës investive, dhe deri në 550.00 €</p> <p>Për qytetarët që janë në mbështetje të skemës së ndihmës sociale (kategoria I & II) subvencionohet gjashtëdhjetë përqind (60%) e vlerës investive, dhe deri në 550.00 €</p>	<p>të brendshme apo sistem multisplit) dhe pajisjet përcjellëse për instalim (nuk përfshihet kostoja e montimit).</p> <p>Kjo pajisje është e aplikueshme për shtëpi dhe banesa (vetëm një pajisje).</p>
--	--	---	---	---

⁷ Në formularin për aplikim online e-Kosova, aplikuesit do t'i kërkohet të shënojë shifrën e konsumatorit të faturës së energjisë elektrike, dhe përmes shifrës së konsumatorit do të merren informatat mbi shpenzimet e konsumit të energjisë elektrike.

⁸ Me të regjistruar konsiderohen konsumatorët që figurojnë në bazën e të dhënave të furnizuesit të energjisë elektrike.

⁹ Në rast të pamundësisë teknike të verifikimit automatik në e-Kosova kërkohet të bashkëngjitet fatura e energjisë elektrike së bashku me dëshmi të pagesës për së paku një muaj nga shkurti 2024 deri në momentin e aplikimit.

¹¹ "Prindi vetushqyes" përkufizohet si prind apo kujdestar ligjor i fëmijës deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, që jeton me fëmijën dhe është përgjegjës i vetëm ligjor dhe financiar i fëmijës. Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Republikën e Kosovës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



**Funded by
the European Union**

	<p>(të ketë muret e jashtme të izoluara termikisht apo ti kenë dyert/dritaret e jashtme në gjendje të mirë teknike dhe fizike dhe së paku të jenë me dy shtresa xhami).</p> <p>e. Shtëpia juaj është e termoizoluar¹⁰.</p>			
Kaldaja me biomasë (dru, pelet, briket).	<p>a. Shtëpia juaj nuk ka qasje në ngrohje të qytetit ose në ngrohje kolektive.</p> <p>b. Jeni konsumatorë aktiv i energjisë elektrike, që verifikohet automatikisht në e-Kosova. Në rast të pamundësisë teknike së verifikimit automatik në e-Kosova kërkohet një faturë e paguar e energjisë elektrike për së paku një muaj nga shkurti 2024 deri në momentin e aplikimit.</p>	<p>a. Certifikatë që dëshmon se shkalla e shfrytëzimit është minimum tetëdhjetë përqind (80%), (vlen për kaldajën me pelet dhe briket).</p> <p>b. Certifikatë që dëshmon se shkalla e shfrytëzimit është minimum gjashtëdhjetë e pesë (65%), (vlen vetëm për kaldajën me dru me eficiencë të lartë).</p>	<p>Subvencionohet shtatëdhjetë përqind (70%) e vlerës investive, dhe deri në 1200.00 €</p>	<p>Subvencionimi përfshin vlerën investive për blerjen e pajisjes dhe pjesët përcjellëse të nevojshme për funksionalizimin e kaldasë. Kjo nuk përfshinë mbulimin e kostos të rrjetit të brendshëm të ngrohjes dhe kostos së montimit.</p> <p>Për arsye teknike, kjo</p>

¹⁰ Mbështjellësi i jashtëm i ndërtesës (shtëpisë): Muret e jashtme të ndërtesës duhet të jenë të izoluara termikisht (p.sh stitopor, lesh guri) dhe dritaret/dyert e jashtme të jenë në gjendje të mirë teknike dhe fizike dhe së paku të jenë me dy shtresa xhami.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



Funded by
the European Union

				pajisje është e aplikueshme vetëm për shtëpi (vetëm një pajisje).
Stufa individuale me biomasë.	a. Jeni konsumatorë aktiv i energjisë elektrike, që verifikohet automatikisht në e-Kosova. Në rast të pamundësisë teknike së verifikimit automatik në e-Kosova kërkohet një faturë e paguar e energjisë elektrike për së paku një muaj nga shkurti 2024 deri në momentin e aplikimit.	a. Për stufat individuale me biomasë nuk ka kriter teknik.	Vlera e subvencionimit për një (1) pajisje është shtatëdhjetë përqind (70%) e vlerës investive, dhe deri në 435.00 € Për prindërit vetushqyes ¹² nëntëdhjetë përqind (90%) e vlerës investive, dhe deri në 560.00 € Për qytetarët që janë në mbështetje të skemës së ndihmës sociale (kategoria I & II) subvencionohet nëntëdhjetë përqind (90%) e vlerës investive, dhe deri në 560.00 €	Subvencionimi përfshin vlerën investive për blerjen e pajisjes dhe pajisjet e nevojshme për funksionalizimin e saj (lidhjen me oxhak). Kjo pajisje është e aplikueshme për shtëpi dhe banesa (vetëm një pajisje). Nga ky subvencionim përjashtohet kamini montues.

¹² “Prindi vetushqyes” përkufizohet si prind apo kujdestar ligjor i fëmijës deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, që jeton me fëmijën dhe është përgjegjës i vetëm ligjor dhe financiar i fëmijës. Ligji Nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Republikën e Kosovës.



3 MËNYRA E APLIKIMIT PËR SUBVENCION

Aplikimi për subvencionim bëhet online përmes platformës e-Kosova.

Hapat për aplikim

1. Sigurohuni që të plotësoni kriterin për aplikim në lidhje me konsumin e energjisë elektrike këtu: <https://ekosova.rks-gov.net/472>. Nëse e plotësoni kriterin e konsumit të energjisë elektrike, si dhe kriteret tjera për aplikim të specifikuar në thirrje, pas njoftimit se jeni kualifikuar, ju mund të vazhdoni me blerjen dhe instalimin e pajisjes.
2. Pas blerjes së pajisjes së përzgjedhur sipas kriterëve të specifikuar më lart, ju mund të vazhdoni aplikimin që të ju mundësohet përfitimi nga ky subvencion, duke plotësuar formularin për aplikim në linkun si më lart dhe duke ngarkuar dokumentet si në vijim:
 - a. Kuponin fiskal të blerjes së pajisjes sipas Administratës Tatimore të Kosovës (*data e blerjes duhet të jetë nga data e shpalljes së thirrjes më datë 12.09.2024 e deri më datën e mbylljes së thirrjes më datë 11.10.2024*);
 - b. Fotografi të pajisjes së blerë dhe instaluar sipas kriterëve të specifikuar në thirrje (për kondicioner/ klimë - pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efikasitet të lartë, fotografi e një (1) njësie të jashtme dhe të brendshme apo të sistemit multisplit);
 - c. Fotografi që dëshmon se shtëpia/banesa juaj është e termoizoluar sipas kriterëve të cekura më lartë (vlen për pompë termike dhe për kondicioner/ klimë - pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efikasitet të lartë);
 - d. Fotografi të numrit serik të pajisjes (nuk vlen për stufat individuale me biomasë);
 - e. Fotografi të etiketës së konformitetit CE së pajisjes (opsionale për kaldajat dhe stufat individuale me biomasë);
 - f. Fotografi të etiketës së performancës energjetike të pajisjes – etiketa e energjisë (opsionale për kaldajat dhe stufat individuale me biomasë);
 - g. Fotografi të koeficientit të performancës së pajisjes (vlen për pompë termike dhe për kondicioner/ klimë - pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efikasitet të lartë), koeficientin e COP ose SCOP (ku është e aplikueshme);
 - h. Fotografi të certifikatës që dëshmon shkallën e shfrytëzimit për kaldajën me biomasë;
 - i. Për prindërit vetëshqyes për përfitim të subvencionit prej nëntëdhjetë përqind (90%) për stufën individuale me biomasë dhe gjashtëdhjetë përqind (60%) për



- pompën termike ajër-ajër inverter (kondicioner/klimë eficiente) kërkohet të ngarkohet një (1) nga dokumentet/dëshmitë¹³ që konfirmon statusin e prindit vetushqyes;
- j. Për aplikuesit që janë përfitues të skemës së ndihmës sociale (kategoria I & II), për përfitim të subvencionit prej nëntëdhjetë përqind (90%) për stufën individuale me biomasë dhe gjashtëdhjetë përqind (60%) për pompën termike ajër-ajër inverter (kondicioner/klimë eficiente) kërkohet të ngarkohet një (1) dëshmi që konfirmon statusin e aplikuesit që është përfitues i skemës sociale (kategoria I & II);
- k. Marrëveshja juaj e subvencionimit do të gjenerohet automatikisht nga platforma e-Kosova me rastin e aplikimit¹⁴. Kjo marrëveshje gjenerohet pas klikimit në hapësirën përkatëse dhe e njëjta duhet të ngarkohet së bashku me dokumentet e sipërpërmendura në këtë platformë.

Në këtë fazë ju kërkohet të vendosni numrin e xhironlogarisë tuaj bankare e cila duhet të jetë në emër të aplikuesit, dhe nga ndonjëra prej bankave të licencuara brenda Republikës së Kosovës.

Pas ngarkimit të dokumenteve të listuara më lartë në platformën online e-Kosova, ju do të pranoni një (1) njoftim automatik me përmbajtjen: “Aplikimi juaj është realizuar me sukses. Aplikacioni juaj do të vlerësohet nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë (ME), i cili do të shqyrtojë nëse dëshmitë e ngarkuara në platformën e-Kosova janë konform kritereve të kësaj thirrjeje. Për rezultatet e aplikimit do të njoftoheni sipas afateve zyrtare”.

Nëse aplikacioni juaj vlerësohet pozitivisht nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë (ME), ju do të njoftoheni përmes platformës e-Kosova dhe do të pranoni mjetet nga subvencionin në xhironlogarinë tuaj.

Inspektimi i pajisjeve të instaluar do të fillojë nga momenti që keni pranuar mjetet financiare të subvencionit.

¹³ Certifikata e bashkësisë familjare dhe kurdo që është e aplikueshme ndonjëherë nga këto dëshmitë si në vijim: certifikata e shkurorëzimit, certifikata e vdekjes, vendim të gjykatës, etj.

¹⁴ Kjo marrëveshje konsiderohet e nënshkruar nga Përfituesi i Subvencionit duke klikuar në hapësirën përkatëse. Udhëzim: Përfituesi i Subvencionit duhet të plotësojë në mënyrë elektronike hapësirat e hijezuara.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy



**Funded by
the European Union**

Afati për aplikim

Afati i fundit për aplikim është **tridhjetë (30) ditë kalendarike** nga dita që hapet thirrja, pra deri më datën **11 tetor të vitit 2024**, ose deri në shpenzimin e buxhetit të alokuar për këtë thirrje. Aplikimet e pranuar do të shqyrtohen bazuar në parimin “KUSH APLIKON I PARI, SHËRBEHET I PARI” andaj inkurajoheni të aplikoni sa më herët.

E drejta për ankesë

Aplikantët të cilët vlerësojnë se aplikimi i tyre nuk është vlerësuar drejtë nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë (ME), mund të ushtrojnë të drejtën e ankesës në afat prej **tridhjetë (30) ditësh**, nga dita e pranimit të njoftimit, konform Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA). Ankesa i drejtohet Ministrisë së Ekonomisë (ME) si autoritet që ka publikuar thirrjen në email adresën: ✉ komisioni.ankesa@rks-gov.net

Sqarime shtesë

Për më shumë informacione dhe sqarime shtesë rreth aplikimit mund të drejtoheni me shkrim në email adresën: ✉ info.subvencionet@rks-gov.net apo të kontaktoni në numrat e telefonit si më poshtë:

☎ 038 200 215 89

☎ 038 200 215 55

Nga e hëna deri të premten, duke filluar nga ora: 08:30-12:00 dhe nga ora 13:00-16:00